**Dr. Musli Vërbani**

# LUTJET E JETËS NGA KURANI FISNIK

*Kaçanik*

# Përmbajtja:

HYRJE........................................................................ 8

**KAPITULLI I PARË .................................................. 15**

**LUTJE PERSONALE .................................................. 15**

LUTJA PËR PRANIMIN E LUTJEVE ........................................ 16
LUTJA PËR PASTRIMIN E SHPIRTIT DHE ZEMRËS ........................ 17
LUTJA PËR SHPËTIM PREJ VËSHTIRËSIVE TË ............................. 18
MËDHA............................................................................ 18
LUTJA PËR SHTËPI TË RE, ÇLIRIM DHE TRIUMF......................... 19
LUTJA PËR DURIM ........................................................ 20
LUTJA KUR JE I HIPUR MBI ANIJE APO UDHËTON ME AEROPLAN ... 21
LUTJA PËR SHËRIM NGA PLOGËSHTIA DHE NGA ÇDO SËMUNDJEJE 22
LUTJA PËR SHPËTIM NGA FATKEQËSITË ................................ 22
LUTJA NDAJ CYTJEVE TË SHEJTANIT DHE MOSAFRIMIT TË TYRE .... 23
LUTJA PËR ZGJERIM TË KRAHARORIT.................................... 24
LUTJA PËR LEHTËSIM TË ÇËSHTJEVE ..................................... 25
LUTJA PËR GJUHË TË PASTËR............................................. 26
LUTJA PËR DITURI......................................................... 28
LUTJA PËR FALJE TË NAMAZIT ........................................... 29
LUTJA PËR DEVOTSHMËRI ................................................ 30
LUTJA PËR FORCIMIN E ZEMRËS DHE TË IMANIT ...................... 31
FALËNDERIMI PËR UDHËZIM NË ISLAM ................................. 32
LUTJA PËR SHPËTIM NGA XHEHENEMI.................................. 32
LUTJA PËR LARGIMIN E PIKËLLIMIT ...................................... 34
LUTJA PËR LËNIE NË KOMPETENCË ÇËSHTJEN TEK ALLAHU ......... 35

LUTJA PËR NDRIÇIM NË DITËN E KIJAMETIT ............................ 36
LUTJA PËR TË NDËRTUAR SHTËPI NË XHENET ........................... 37
MBËSHTETJA NË ALLAHUN ................................................. 38
MBËSHTETJA NË ALLAHUN ................................................. 39
DUAJA QË KUR TË VDESËSH TË VDESËSH NË ISLAM ................... 40
MBËSHTETJE DHE PAJTUESHMËRI PREJ ALLAHUT ...................... 40
LUTJA PËR MËSHIRË.......................................................... 41
LUTJA PËR MËSHIRË DHE QETËSIM ....................................... 43
LUTJA PËR FALJEN E GABIMEVE TË PRINDËRVE ......................... 44
LUTJA PËR MËSHIRË PRINDËRVE ........................................... 45
LUTJA PËR MËSHIRË.......................................................... 46
LUTJA PËR MBROJTJE DHE MËSHIRË ..................................... 47
LUTJA PËR KËRKIMIN E FALJES DHE MËSHIRËS.......................... 48
LUTJA PËR FALJE ............................................................. 49
LUTJA PËR FALJE GABIMESH DHE SHPËTIM NGA ZJARRI .............. 50
LUTJA PËR FURNIZIM ........................................................ 51
LUTJA PËR TË MIRAT E KËSAJ BOTE ...................................... 51
LUTJA PËR POZITË ............................................................ 53
LUTJA PËR QEVERISJE......................................................... 54
LUTJA PËR QEVERISJE TË VEÇANTË ........................................ 55

**KAPITULLI I DYTË ....................................................... 56**

**LUTJE PËR FAMILJEN .................................................. 56**

LUTJA PËR BASHKËSHORTE TË MIRË, FËMIJË TË MIRË DHE DEVOTSHMËRI.......................................................... 57
LUTJA PËR FËMIJE TË MIRË ................................................. 58
LUTJA PËR FËMIJË TË MIRË ................................................. 59
LUTJA PËR FËMIJË TË MIRË ................................................. 60

LUTJA PËR FALJEN E NAMAZIT VETË DHE NË FAMILJE ................ 61
LUTJA PËR FAMILJE TË SHËNDOSHË DHE FALËNDERIM ............... 62
LUTJA PËR RUAJTJE TË FAMILJES KUR JE APO JAN NË GURBET ...... 63
LUTJA PËR KTHIMIN E TË ZHDUKURVE (APO GJETJEN E TË PAGJETURVE) ........................................................... 64

**LUTJA PËR QYTETIN DHE SHOQËRINË....................... 66**

LUTJA PËR RRIZK, PAQE DHE LUMTURI NË QYTET...................... 67
LUTJA PËR PAQE NË QYTET DHE LARGIM TË QYTETARËVE NGA IDHUJTARIA ............................................................. 68

**LUTJA PËR TË SHPËTUAR NGA ARMIKU .................... 70**

LUTJA PËR SHPËTIM NDAJ TË KORRUPTUARVE ......................... 71
LUTJA PËR TË FITUAR BETEJËN ............................................ 72
LUTJA PËR SHPËTIM PREJ KRIMINELËVE DHE PABESIMTARËVE ..... 73
LUTJA PËR SHPËTIM NDAJ KRIMINELËVE ................................ 74
LUTJA KUNDËR FITNEVE.................................................... 74
FALËNDERIM PËR SHPËTIMIN NGA POPULLI KRIMINEL ............... 76
LUTJA PËR PARAGJYKIM TË MIRË TË POPULLIT NDAJ VETVETES .... 77
LUTJA PËR SHPËTIM NDAJ PABESIMTARËVE............................ 78

# LUTJET E JETËS NGA KUR'ANI FISNIK

# Hyrje

Lutja është pjesë e natyrës njerëzore. Njeriu kur të sëmuret, e humb shëndetin, e me këtë edhe fuqinë, dobësohet, e Allahu e mëshiron dhe e shëron. Pejgamberi s.a.v.s. na ka porositur të kërkojmë shërim, shpëtim dhe sigurim tek Allahu i Lartmadhëruar.

Lutja është arma e besimtarit, shtyllë e fesë, dritë e qiejve dhe e Tokës, me të cilën qetësohen zemrat dhe shpirtrat.

Zoti i Lartmadhëruar gëzohet kur besimtari i lutet Atij, ndërsa hidhërohet kur besimtari e braktis lutjen.

Zoti i Lartmadhëruar në Kuranin famëlartë thotë:

**"E kur robërit e Mi të pyesin (O Muhamed) për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së atij që lutet…"**

Lutja është shpresë dhe kërkesë drejtuar Allahut xh.sh. Lutja është truri i ibadetit. Lutja është shkak i fuqishëm për largimin e fatkeqësive. Lutja është ushqim shpirtëror dhe mendor. Istigfari është metoda më e suksesshme për shërim nga sëmundjet psikike.

Njeriu, i cili vazhdimisht bën istigfar është i mbrojtur nga fatkeqësitë, dëmi dhe rreziqet.

Në Kur'an hasim ajete të shumta, të cilat flasin për lutjen. Kur'ani në vete përmban forma të ndryshme të lutjeve, të istigfarit, të madhërimit dhe të lavdërimit të Allahut. Me leximin e ajeteve njeriu qetësohet në aspektin psiqik dhe shpirtëror. Shumë ajete në Kur'an kanë të bëjnë me shërimin, mbrojtjen dhe me kërkesa tjera.

Përderisa lutja është ibadet, lexues i nderuar: Lute Zotin me zemër, me shpresë, me durim, me sinqeritet, me bindje të thellë dhe me vendosmëri. Ta dish se lutja ka shtyllat, degët, kohën dhe arsyen e saj. Nëse e qëllon shtyllën, forcohesh, nëse i qëllon degët lartësohesh, e nëse e qëllon kohën dhe arsyen, shpëton. Shtylla e saj është që të bëhet me gjithë zemër dhe duke shpresuar në bekimin e Allahut xh.sh. Degët e saj janë sinqeriteti dhe ushqimi hallall, kurse koha është kur njeriu është i vetmuar dhe i qetë shpirtërisht, arsyet e pranimit janë salavatet mbi Muhamedin a.s.

Kur'ani fisnik na shpjegon raste të pejgamberëve. Njeriu i parë i njerëzimit dhe pejgamberi i parë, Ademi a.s. kishte bërë

gabim. Pastaj Zoti i Lartëmadhëruar e mësoi që të lutet, e pas lutjes t'ia falë gabimin. Ademi a.s e luti Zotin t'ia falë gabimin, dhe Zoti e fali.

Pas një kohe vjen pejgamberi i Allahut, Nuhu a.s. Ai  950 vite thirri në rrugë të drejtë, mirëpo populli i tij nuk e dëgjonte. Ai u mundua t'i thërrasë në të gjitha format e mundshme; haptazi e fshehurazi; ditën e natën. Kur e pa se nuk ka shpresë, atëherë iu lut Zotit që ta shpëtojë prej popullit pabesimtar, dhe Zoti e shpëtoi.

Ejubi a.s. ishte sëmurë, kishte humbur pasurinë dhe fëmijët, kishte mbetur i vetmuar, kur iu lut Zotit të Lartmadhëruar, Ai iu përgjigj, e shëroi, i dha shëndet, fëmijë dhe pasuri.

**"Edhe Ejubi, kur e thirri në ndihmë Zotin e vet: Më gjeti fatkeqësia, kurse Ti je më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve. Iu përgjigjëm nga mëshira Jonë dhe fatkeqësinë që e mundonte ia hoqëm, dhe ia dhamë familjen, dhe krahas tyre edhe aq (ia dyfishuam familjen), që të jetë mësim për adhuruesit."** (El-Enbija, 83-84)

Junusi a.s. ishte në momentet më të vështira, në thellësi të detit, në errësirën e barkut të peshkut, por edhe në këtë gjendje iu lut Zotit, dhe Zoti e shpëtoi nga vdekja e sigurt.

**“Edhe Dhen-Nuni (Junusi), kur shkoi i zemëruar dhe mendoi se atij nuk kemi çka t’i bëjmë, po pastaj në errësirë thirri: Nuk ka Zot përveç Teje, Ty të takon Lavdërimi, Unë me të vërtetë isha prej të padrejtëve. Iu përgjigjëm dhe e shpëtuam nga ajo që e shtrëngonte. Kështu Ne i shpëtojmë besimtarët”.** (El Enbija, 87-88).

Zekerijau a.s. ishte plakur, eshtrat iu kishin dobësuar, ishte thinjur i tëri, gruaja e tij ishte plakur, por kur iu lut Zotit t’i japë fëmijë, Zoti ia plotësoi dëshirën dhe ia dhuroi djalin (Jahja), i cili ishte edhe pajgamber, i ditur, i urtë, i sjellshëm për familjen dhe i devotshëm.

Zoti i Lartëmadhëruar në Kuran thotë:

**“Edhe Zekerijas, kur e luti Zotin e vet: O Zoti im, mos më lër të vetmuar, e Ti je trashëgimtari më i mirë. Iu përgjigjëm, dhe atij i dhuruam Jahjanë dhe bashkëshorte të mirë. Ata vërtet ishin që nxitonin të bënin punë të mira dhe na lutnin me shpresë dhe frikë, dhe ndaj Nesh ishin të përulur”**. (El-Enbija, 89-90)

Në Kur’an shumë ajete flasin për lutjen, ato kanë të bëjnë me shërimin, tejkalimin e rreziqeve, tejkalimin e fatkeqësive, shtimin e të mirave dhe kërkesave tjera:

**“O Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë pa qëllim.**

**O Zoti ynë, mos na ngarko me barrën që ua ke ngarkuar atyre para nesh.**

**O Zoti ynë, mos na ngarko me atë çka nuk kemi mundësi. Shlyeji mëkatet tona, na falë, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë i vetëm, andaj na ndihmo kundër popullit pabesimtarë.** (El Bekare, 286)

# KAPITULLI I PARË

# LUTJE PERSONALE

# Lutja për pranimin e lutjeve

“...Rabbena tekabbel minna.
Inneke entes-Semiul Alimë.”

رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ...

**“O Zoti ynë, pranoje nga ne.
Vërtet Ti je Dëgjues, i Ditur.”**

(El-Bekare, 127)

# Lutja për pastrimin e shpirtit dhe zemrës

"Rabbenagfir lena veli ihvaninel-ledhine
sebekuna bil iman.
Ve la texhë'al-lena fi kulubina gil-len
lil-ledhine amenu.
Rabbena inneke reufun rahim."

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا ...
بِالْإِيمَانِ وَلا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلّاً لِلَّذِينَ آمَنُوا
رَبَّنَا إِنَّكَ رَؤُوفٌ رَحِيمٌ

**"Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët para nesh u pajisën me besim, dhe mos lejo që në zemrat dhe shpirtrat tanë të ketë urrejtje ndaj atyre që besuan.**
**Zoti ynë, Ti je i Butë, Mëshirues."**

# Lutja për shpëtim prej vështirësive të mëdha

“Rabbenakshif annel adhabe inna muëminun.”

رَبَّنَا اكْشِفْ عَنَّا الْعَذَابَ إِنَّا مُؤْمِنُونَ

**“Zoti ynë, largoje prej nesh dënimin, vërtet ne të besojmë.”**

(Ed-Duhan, 12)

# Lutja për shtëpi të re, çlirim dhe triumf

“Rabbi ed-hilnij mud-hale sidkin ve ehrixhnij muhrexhe sidkin vexh`alnij min ledunke sultanen nesira.”

رَبِّ أَدْخِلْنِي مُدْخَلَ صِدْقٍ وَأَخْرِجْنِي مُخْرَجَ ... صِدْقٍ وَاجْعَلْ لِي مِنْ لَدُنْكَ سُلْطَاناً نَصِيراً

**“Zoti im, më shpjer në vend të mirë, dhe më nxirr në mënyrë të mirë dhe të ndershme, dhe nga ana jote më dhuro fuqi ndihmuese (të çlirohem dhe të triumfoj).”**

(El-Isra, 80)

# <u>Lutja për durim</u>

“Fe sabrun xhemilë, vallahul muste’anu ala ma jesifunë.”

... فَصَبْرٌ جَمِيلٌ وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَى مَا تَصِفُونَ

**“Durimi është më i miri. Allahut i kërkohet ndihmë për atë që i përshkruani ju.”**

(Jusuf, 18)

# <u>Lutja kur je i hipur mbi anije apo udhëton me aeroplan</u>

“Bismil-lahi mexhreha ve mursaha inne Rabbij le Gafurun Rrahimë.”

... بِسْمِ اللَّهِ مَجْرَاهَا وَمُرْسَاهَا إِنَّ رَبِّي لَغَفُورٌ رَحِيمٌ

**“Me emrin e Allahut lundron (fluturon) dhe ndalet.**
**Vërtet Zoti im është Falës, Mëshirues.”**

(Hudë, 41)

## Lutja për shërim nga plogështia dhe nga çdo sëmundjeje

“Ennij messenijed-durr-rru ve ente erhamurr-rrahiminë.”

أَنِّي مَسَّنِيَ الضُّرُّ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ...

**“Vërtetë më ka kapluar plogështia dhe Ti je më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.”**

(Enbija, 83)

## Lutja për shpëtim nga fatkeqësitë

“La ilahe il-la ente subhaneke innij kuntu minedh-dhaliminë.”

لا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ ... الظَّالِمِينَ

**“Nuk ka zot përveç Teje, Ty të takon lavdërimi.**
**Vërtetë unë isha prej të padrejtëve.”**

(El-Enbija, 87)

## Lutja ndaj cytjeve të shejtanit dhe mosafrimit të tyre

"Rabbi eudhu bike min hemezatish-shejatinë, ve eudhu bike rabbi en jahdurunë."

. رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ ...
. وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ

**"O Zoti im, unë kërkoj mbrojtje prej Teje (mbështetem te Ti) prej cytjeve (prekjeve dhe ngacmimeve) të djajve, dhe mbështetem te Ti që ata të mos më afrohen."**

(El-Muëminunë, 98)

## Lutja për zgjerim të kraharorit

“Rabishrah lij sadrij.
Ve jessir lij emrij.”

. رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي . وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي ...

**“Zoti im, zgjero kraharorin tim.
Dhe lehtëso çështjet e mia.”**

(Ta Ha, 25)

## Lutja për lehtësim të çështjeve

“Rabishrah lij sadrij.
Ve jessir lij emrij.”

. رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي . وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي ...

**“Zoti im, zgjero kraharorin tim.**
**Dhe lehtëso çështjet e mia.”**

(Ta Ha, 26)

## Lutja për gjuhë të pastër

Kale Rabbishrah lij sadrij,
ve jessir lij emrij,
vehlul ukdeten min lisanij,
jefkahuu kavlij.”

قَالَ رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي . وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي .
وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِنْ لِسَانِي . يَفْقَهُوا قَوْلِي

**“Zoti im, zgjero kraharorin tim,**
**lehtëso çështjen time,**
**çliro nyjen nga gjuha ime,**
**që të kuptohet fjala ime.”**

(TaHa, 27- 28)

# Lutja për dituri

“Rabbi zidnij ilma.”

رَبِّ زِدْنِي عِلْماً ...

**“O Zoti im, më shto mua dituri.”**

(Ta Ha, 114)

# Lutja për falje të namazit

“Rabbixh’alnij mukijmes-salati.”

... رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلاةِ

**“Zoti im, më bën falës të namazit.”**

(Ibrahim, 40)

# Lutja për devotshmëri

“Semiëna ve etaëna, gufraneke Rabbena
ve ilejkel mesijrë.”

سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ...

**“... dëgjuam dhe pranuam, falje vetëm prej Teje kërkojmë, o Zoti ynë,**
**dhe përfundimin e kemi tek Ti.”**

(El-Bekare, 285)

# Lutja për forcimin e zemrës dhe të imanit

“Rabbena la tuzig kulubena beade idh hedejtana,
ve heb lena min ledunke rahmeten,
Inneke entel Vehhab.”

رَبَّنَا لا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

**“Zoti ynë, mos lejo të rrëshqasin zemrat tona pasi që na ke udhëzuar,
dhe na dhuro nga Ti mëshirë,
vërtet Ti je Bujar.”**

(Ali Imran, 8)

# Falënderimi për udhëzim në Islam

“Elhamdu lil-lahil-ledhi hedana li hadha ve ma kunna li nehtedije leu la en hedanall-llah.”

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ ... لَوْلا أَنْ هَدَانَا اللَّهُ...

**“Falënderojmë Allahun, i Cili na udhëzoi në këtë fe Islame, se po të mos na kishte udhëzuar, nuk do të kishim qenë të udhëzuar.”**

(El-Earafë, 43)

# Lutja për shpëtim nga xhehenemi

“Rabbenasrif anna adhabe xhehennem,
inne adhabeha kane garama,
inneha saet mustekarren ve mukama.”

رَبَّنَا اصْرِفْ عَنَّا عَذَابَ جَهَنَّمَ إِنَّ عَذَابَهَا كَانَ غَرَاماً .
إِنَّهَا سَاءَتْ مُسْتَقَرّاً وَمُقَاماً .

**“Zoti ynë, largo nga ne dënimin e xhehenemit,**
**vërtet dënimi në të është i papërballueshëm,**
**vërtet, nuk ka vendbanim dhe vendqëndrim më të keq.”**

(Furkan, 65-66)

# Lutja për largimin e pikëllimit

“Elhamdu lil-lahil-ledhij edhhebe annel hazen.”

... الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَذْهَبَ عَنَّا الْحَزَنَ ...

**“Falënderimi i takon Allahut, i Cili largoi nga ne pikëllimin.”**

(Fatir, 35)

# Lutja për lënie në kompetencë çështjen tek Allahu

“Ve ufevvidu emrij ilall-llah.
Innell-llahe besirun bil ibadë.”

وَأُفَوِّضُ أَمْرِي إِلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ ...

**“Po i lë çështjet e mia në kompetencë të Allahut. Vërtet, Allahu i sheh robërit.”**

(El-Gafir, 44)

# Lutja për ndriçim në Ditën e Kijametit

“Rabbena etmim lena nurena,
vegfir lena,
inneke ala kul-li shej in kadiirë.”

رَبَّنَا أَتْمِمْ لَنَا نُورَنَا وَاغْفِرْ لَنَا إِنَّكَ عَلَى كُلِّ ...
شَيْءٍ قَدِيرٌ

**“Zoti ynë, na plotëso dritën tonë,**
**na fal ne,**
**vërtet Ti ke mundësi për gjithçka.”**

(Tahrimë, 8)

# Lutja për të ndërtuar shtëpi në xhenet

“Rabbibni lij ‘indeke bejten fil xhenneti.”

... رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتاً فِي الْجَنَّةِ ...

**“Zoti im, më ndërto mua një shtëpi në Xhenet.”**

(Et-Tahrimë, 11)

# <u>Mbështetja në Allahun</u>

“Hasbunall-llahu ve niëmel vekijlë.”

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ...

**“Na mjafton Allahu,**
**nuk ka mbrojtës më të mirë.”**

(Ali Imran, 173)

# Mbështetja në Allahun

“Inil hukmu il-la lil-Lah,
alejhi tevekkeltu,
ve alejhi fel jetevekkelil mutevekkilunë.”

... إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ

**“Padyshim vendimi i takon vetëm Allahut,
vetëm Atij i jam mbështetur,
dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që kanë besuar (mbështetur).”**

(Jusuf, 67)

# Duaja që kur të vdesësh të vdesësh në Islam

“Teveffeni muslimen,
Ve elhiknij bis-salihinë.”

تَوَفَّنِي مُسْلِماً وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ ...

**“Më bën që të vdes musliman dhe më përcjell te të mirët.”**

(Jusuf, 101)

# Mbështetje dhe pajtueshmëri prej Allahut

“Ve ma tevfikij il-la bil-lah
Alejhi tevekkeltu
Ve ilejhi unibë.”

وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَإِلَيْهِ أُنِيبُ ...

**“I mbështetem dhe kërkoj pajtueshmëri prej Allahut vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm te Ai jam i drejtuar.”**

(Hudë, 88)

## Lutja për mëshirë

“Rabbigfir verham
ve ente hajrurr-Rrahiminë.”

رَبِّ اغْفِرْ وَارْحَمْ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّاحِمِينَ

**“O Zoti im, më fal, më mëshiro,
Ti je më i miri Mëshirues.”**

(El-Muëminun, 118)

# Lutja për mëshirë dhe qetësim

“Rabbena atina min ledunke Rahmeten
ve hejjië lena min emrina resheda.”

رَبَّنَا آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا ...
رَشَداً

**“Zoti ynë, na jep mëshirë prej mëshirës Tënde,**
**dhe në çështjet tona na pajis udhëzim.”**

(El-Kehf, 10)

# Lutja për faljen e gabimeve të prindërve

“Rabbenagfir lij
ve livalideje
ve lil muëminine jevme jekumul hisabë.”

رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ

**“Zoti ynë, më fal mua,
prindërit e mi,
dhe besimtarët Ditën kur jepet llogaria.”**

(Ibrahimë, 41)

# Lutja për mëshirë prindërve

“Rabbirham huma kema rabbejanij sagira.”

رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيراً ...

**“Zoti im, mëshiroji (dy prindërit e mi) ashtu siç më edukuan në vegjëli.”**

(El-Isra, 24)

# Lutja për mëshirë

“Rabbena la tuzig kulubena beade idh hedejtena
ve heb lena min ledunke rahmeten
inneke entel Vehhabë.”

رَبَّنَا لا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

**“O Zoti ynë, mos lejo që të rrëshqasin zemrat tona pasi që na ke udhëzuar
dhe na dhuro nga Ti mëshirë,
Vërtet Ti je Bujar.”**

(Ali Imran, 8)

# Lutja për mbrojtje dhe mëshirë

"Fall-llahu hajrun Hafidha
ve huve erhamurr-Rrahiminë."

فَاللَّهُ خَيْرٌ حَافِظاً وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ...

**"Allahu është ruajtësi dhe mbrojtësi më i Miri dhe Ai është më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve."**

(Jusuf, 64)

# Lutja për kërkimin e faljes dhe mëshirës

"Rabbena dhalemna enfusena
ve in lem tegfir lena
ve terhmana
lenekunenne minel hasirinë."

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا
لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

**"Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi
vetes sonë,
nëse nuk na fal gabimet tona
dhe nuk na mëshiron,
do të jemi prej të humburve."**

(Earaf, 23)

# Lutja për falje

“Rabbenagfir lena dhunubena
ve israfena.”

... رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا ...

**“Zoti ynë, na fal neve gabimet tona dhe tejkalimet tona (në vepra).”**

(Ali Imran, 147)

# Lutja për falje gabimesh dhe shpëtim nga zjarri

“Rabbena innena amenna
fegfir lena dhunubena
ve kina adhaben-narë.”

رَبَّنَا إِنَّنَا آمَنَّا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ...

**“Zoti ynë ne të kemi besuar plotësisht,**
**na fal gabimet tona,**
**dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit.”**

(Ali Imran, 16)

## Lutja për furnizim

“Tuligjul lejle fin-nehari ve tuligjun nehare fil-lejl
ve tuhrigjul hajje minel mejjiti ve tuhrigjul mejjite minel hajj
ve terzuku men teshau bigajri hisabë.”

تُولِجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَتُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَتَرْزُقُ مَنْ تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ

**“Ti e fute natën në ditë dhe Ti e fute ditën në natë, Ti nxjerr nga i vdekuri të gjallin dhe nga i gjalli të vdekurin dhe Ti e begaton pa masë atë që do!”**

(Ali Imran, 27)

## Lutja për të mirat e kësaj bote

“Rabbena atina fid-dunja haseneten
ve fil ahireti haseneten
ve kina adhaben-narë.”

... رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً
وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

**“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë
dhe në botën tjetër na jep të mira,
dhe mbrona nga zjarri i Xhehenemit.”**

(El-Bekare, 201)

# Lutja për pozitë

“Allahumme malikel mulki, tuëtil mulke men teshau, ve tenzi’ul mulke mimmen teshau, ve tu’izzu men teshau, ve tudhil-lu men teshau, bi jedikel hajr, inneke ala kul-li shej in kadirë.”

اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ
مِمَّنْ تَشَاءُ وَتُعِزُّ مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ بِيَدِكَ الْخَيْرُ
إِنَّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

**“Zoti im, Sundimtar absolut i të gjithë sundimtarëve,**
**i jep sundim cilit do Ti,**
**e zbret nga sundimi cilin do Ti,**
**e ngritë në pozitë të lartë cilin do Ti,**
**e zbret nga pozita cilin do Ti,**
**në dorën Tënde është e mira,**
**vërtet Ti ke mundësi për çdo send.”**

(Ali Imran, 26)

# <u>Lutja për qeverisje</u>

"Rabbi heb lij hukmen
ve elhiknij bis-salihinë."

رَبِّ هَبْ لِي حُكْماً وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ

**"Zoti im, më dhuro qeverisje
dhe më bën prej bamirësve."**

(Shu'araë, 83)

# Lutja për qeverisje të veçantë

“Rabbigfir lij
ve heb lij hukmen la jenbegij liehadin min beadij
inneke entel vehhabë.”

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَهَبْ لِي مُلْكاً لا يَنْبَغِي لِأَحَدٍ ...
مِنْ بَعْدِي
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

**“Zoti im, më fal,**
**dhe më jep qeverisje, të cilën nuk mund ta ketë askush pas meje,**
**vërtet Ti je Bujar.”**

(Sadë, 35)

# KAPITULLI I DYTË

# LUTJE PËR FAMILJEN

# Lutja për bashkëshorte të mirë, fëmijë të mirë dhe devotshmëri

“Rabbena heb lena min ezvaxhina
ve dhurr-rrijjatina kurr-rrate eajunin
vexh’alna lil muttekine imama.”

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ ...
وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَاماً

**“Zoti ynë, na dhuro prej bashkëshorteve tona,
dhe prej pasardhësve tanë,
prej atyre që na pushon syri e na qetësohet zemra
dhe na bën shëmbëlltyrë për të devotshmit.”**

(Furkan, 74)

# <u>Lutja për fëmije të mirë</u>

“Rabbi la tedhernij ferden
ve ente hajrul-varithijnë.”

رَبِّ لا تَذَرْنِي فَرْداً وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ ...

**“Zoti im, mos më lër të vetëm,**
**Ti je trashëguesi më i miri.”**

(El-Enbija, 89)

# Lutja për fëmijë të mirë

“Rabbi heb li min ledunke dhurr-rrijjeten
tajjibeh,
inneke semiud-du’aë.”

رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً إِنَّكَ سَمِيعُ ... الدُّعَاءِ

**“Zoti im, më dhuro nga Ti pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet Ti i dëgjon lutjet.”**

(Ali Imran, 38)

# Lutja për fëmijë të mirë

“Rabbi heb lij mines salihinë.”

رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ

**“Zoti im, më dhuro fëmijë prej të mirëve.”**

(Es-Saffatë, 100)

# Lutja për faljen e namazit vetë  dhe në familje

“Rabbixh’alnij mukimes salati
ve min dhurr-rrijjetij
Rabbena ve tekabbel duaë.”

رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي رَبَّنَا
وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ

**“Zoti im, më bën mua falës të namazeve,**
**dhe prej pasardhësve të mi,**
**Zoti ynë, pranoje lutjen time.”**

(Ibrahim, 40)

# Lutja për familje të shëndoshë dhe falënderim

“Rabbi evziënij en eshkureke niëmetekel-letij
en’amte alejje
ve ala validejje
ve en eamele salihan terdahu,
ve eslih lij fi dhurr-rrijjetij
innij tubtu ilejke ve innij minel musliminë.”

رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَى ... وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحاً تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ

**“Zoti im, më bën të të falënderoj për të mirat që m’i ke dhënë mua dhe prindërve të mi, më bën të bëj punë të mira, me të cilat do të jesh i kënaqur, më bën të mirë mua dhe pasardhësit e mi, unë pendohem vetëm tek Ti dhe unë jam prej të dorëzuarve (musliman).”**

(El-Ahkafë, 15)

# Lutja për ruajtje të familjes kur je apo jan në gurbet

“Fall-LLahu hajrun hafidha
ve huve erhamurr-Rrahiminë.”

فَاللَّهُ خَيْرٌ حَافِظاً وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ...

**“Allahu është ruajtësi dhe mbrojtësi më i Miri dhe Ai është më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.”**

(Jusuf, 64)

# Lutja për kthimin e të zhdukurve (apo gjetjen e të pagjeturve)

“Fe sabrun xhemilë
‘asall-llahu en jeëtijenij bihim xhemi’a
innehu huvel Alimul Hakimë.”

فَصَبْرٌ جَمِيلٌ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَنِي بِهِمْ جَمِيعاً ..
إِنَّهُ هُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

**“Durimi është më i miri,
ndoshta Allahu m’i kthen të gjithë,
vërtet Ai është i Ditur, i Urtë.”**

(Jusuf, 83)

# LUTJA PËR QYTETIN DHE SHOQËRINË

# Lutja për rrizk, paqe dhe lumturi në qytet

“Rabbixh’al hadhel beleden aminen,
verzuk ehlehu mineth-themerati
men amene minhum bil-lahi vel jevmil
ahiri.”

رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَداً آمِناً وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ ...
... الثَّمَرَاتِ مَنْ آمَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الآخِرِ ...

**“Zoti im, bëje këtë qytet të qetë dhe të sigurt, furnizo banorët e tij me fruta (të mira),**
**atë që prej tyre beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit.”**

(El-Bekare, 126)

# Lutja për paqe në qytet dhe largim të qytetarëve nga idhujtaria

"Rabbixh'al hadhel belede aminen
vexhnubnij ve benijje
en neabudel esnam."

رَبِّ اجْعَلْ هَذَا الْبَلَدَ آمِناً وَاجْنُبْنِي وَبَنِيَّ أَنْ ... 
نَعْبُدَ الأَصْنَامَ

**"Zoti im, bëre këtë qytet të qetë dhe të sigurt,**
**më mbro mua dhe fëmijët e mi nga adhurimi i idhujve."**

(Ibrahimë, 35)

# LUTJA PËR TË SHPËTUAR NGA ARMIKU

# Lutja për shpëtim ndaj të korruptuarve

“Rabbinsurnij ‘alel kavmil mufsidinë.”

رَبِّ انْصُرْنِي عَلَى الْقَوْمِ الْمُفْسِدِينَ ...

**“Zoti im, më ndihmo të fitoj prej popullit shkatërrimtar (të korruptuar).”**

(El-Ankebutë, 30)

# Lutja për të fituar betejën

"Rabbena efrig 'alejna sabren
ve thebbit ekdamena
vensurna 'alel kavmil kafirinë"

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْراً وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا ...
وَانْصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

**"Zoti ynë, na pajis neve me durim,
na forco këmbët tona,
dhe na ndihmo ndaj popullit
pabesimtar."**

(El-Bekare, 250)

# Lutja për shpëtim prej krimineleve dhe pabesimtarëve

“Rabbena la texh’alna fitneten lil kavmidh-dhaliminë,
ve nexhxhina birahmetike minel kavmil kafirinë.”

. رَبَّنَا لا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ...
. وَنَجِّنَا بِرَحْمَتِكَ مِنَ الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

**“Zoti ynë, mos i jep rast popullit kriminel të na sprovojë,
dhe me mëshirën Tënde na shpëto prej popullit pabesimtar.”**

(Junus, 85-86)

## Lutja për shpëtim ndaj krimineléve

“Rabbi nexhxhinij minel kavmidh-
dhaliminë.”

رَبِّ نَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ...

**“Zoti im, më shpëto nga populli kriminel.”**

(El-Kasas, 21)

## Lutja kundër fitneve

“Rabbena la texh’al-lena fitneten lil-
ledhine keferu,
vagfir lena Rabbena
inneke entel Azizul Hakimë.”

رَبَّنَا لا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا وَاغْفِرْ لَنَا رَبَّنَا
إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

**“Zoti ynë, mos na bën që të sprovohemi nga populli pabesimtar,**
**falna gabimet tona o Zoti ynë,**
**vërtet Ti je i Fuqishëm, i Urtë.”**

(El-Mumtehine, 4)

# Falënderim për shpëtimin nga populli kriminel

“Elhamdu li-lahil-ledhi nexhana minel kavmidh- dhaliminë.”

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي نَجَّانَا مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ...

**“Falënderimi i takon Allahut, i Cili na shpëtoi nga populli kriminel.”**

(El-Muëminunë, 28)

# Lutja për paragjykim të mirë të popullit ndaj vetvetes

“Rabbihkum bil hak
ve Rabbunerr-Rrahmanul-muste’anu ‘ala
ma tesifunë.”

رَبِّ احْكُمْ بِالْحَقِّ وَرَبُّنَا الرَّحْمَنُ الْمُسْتَعَانُ ...
عَلَى مَا تَصِفُونَ

**“Zoti im, gjyko me meritë (mes meje dhe atyre).”**
**O Zoti ynë Bamirës, Ti je Ai te i Cili kërkohet ndihmë dhe mbrojtje ndaj atyre që i veshin Allahut (çështje të ndaluara).”**

(Enbija, 112)

# Lutja për shpëtim ndaj pabesimtarëve

“Innij maglubun fentesir.”

أَنِّي مَغْلُوبٌ فَانْتَصِرْ ...

**“Vërtet unë jam i mundur, më ndihmo.”**

(El-Kamer, 10)